

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK



DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE

PROGRAMI MASTER

Tema:

***“Transparenca dhe llogaridhënja në administratën publike
në komunën e Podujevës”***

Mentori:

Prof. Dr. Afrim Hoti

Kandidatja:

Drita Pajaziti

Prishtinë, 2026

REZYME

"Transparenca dhe llogaridhënia në administratën publike: Rasti i Komunës së Podujevës"

Ky punim paraqet një analizë të detajuar të rolit të transparencës dhe llogaridhënies në funksionimin e administratës publike lokale, duke u fokusuar në identifikimin e mekanizmave që ndikojnë në përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike. Punimi trajton aspektet teorike të transparencës dhe llogaridhënies, duke analizuar përkufizimet, rëndësinë e tyre në administratën publike, faktorët që ndikojnë në zbatimin e këtyre parimeve, praktikat dhe politikat ndërkombëtare, si dhe modelet kryesore të kontrollit administrativ që kontribuojnë në forcimin e përgjegjshmërisë institucionale.

Me mbështetje në literaturën shkencore bashkëkohore, dokumentet ligjore dhe institucionale, raportet e organizatave ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të vendeve me nivele të larta të transparencës, punimi ndërton një bazë të qëndrueshme teorike mbi rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike. Studimi ndërthur analizën teorike me hulumtimin empirik të realizuar në Komunën e Podujevës, duke vlerësuar perceptimet e qytetarëve dhe të punonjësve të administratës publike lidhur me funksionimin e mekanizmave të transparencës, përdorimin e teknologjisë, pjesëmarrjen qytetare dhe faktorët që ndikojnë në rritjen e përgjegjshmërisë institucionale.

Analiza empirike mbështetet në të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve dhe intervistave, të cilat mundësuan vlerësimin e nivelit të transparencës në administratën publike të Komunës së Podujevës. Në këtë pjesë analizohen publikimi i informacionit mbi shpenzimet publike, pengesat që kufizojnë transparencën dhe llogaridhënien, efektiviteti i platformave të e-qeverisjes, niveli i përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse, motivimi i punonjësve, ndikimi i etikës profesionale dhe cilësisë së shërbimeve publike, si dhe testohen hipotezat e studimit përmes analizave statistikore, duke përfshirë korrelacionin e Pearsonit dhe testin *t*.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se implementimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë, përdorimi i teknologjisë dhe platformave të e-qeverisjes, si dhe angazhimi aktiv i qytetarëve ndikojnë pozitivisht në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike. Studimi

evidenton gjithashtu se burokracia, ndërhyrjet politike, mungesa e kapaciteteve profesionale dhe kufizimet teknologjike mbeten sfida të rëndësishme për administratën publike lokale. Punimi thekson nevojën për forcimin e mekanizmave institucionalë, avancimin e transformimit digjital, rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe zhvillimin e politikave që promovojnë një administratë publike më transparente, më efikase dhe më të përgjegjshme ndaj qytetarëve.

Struktura e punimit:

Pjesa hyrëse: Në këtë pjesë paraqiten sfondi i studimit, rëndësia e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike, qëllimi dhe objektivat e hulumtimit, pyetjet kërkimore, hipotezat dhe metodologjia e përdorur. Gjithashtu argumentohet rëndësia e forcimit të mekanizmave të transparencës, përdorimit të teknologjisë dhe përfshirjes së qytetarëve për ndërtimin e një administrate publike më të hapur, më efikase dhe më të përgjegjshme.

Në kapitullin e parë: Trajtohet kuadri teorik i studimit, duke u fokusuar në konceptin e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike. Analizohet rëndësia e transparencës në qeverisje, faktorët që ndikojnë në funksionimin e saj, praktikrat dhe politikat ndërkombëtare për rritjen e transparencës, si dhe paraqiten raste studimore të vendeve me nivele të larta të transparencës dhe qeverisjes së mirë.

Në kapitullin e dytë: Analizohen modelet e kontrollit në administratën publike, duke trajtuar kontrollin politik, kontrollin administrativ dhe kontrollin kontabël si mekanizma të rëndësishëm për garantimin e transparencës, ligjshmërisë dhe llogaridhënies në institucionet publike. Në këtë kapitull shqyrtohet edhe rëndësia e këtyre mekanizmave në forcimin e performancës institucionale dhe në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj administratës publike.

Në kapitullin e tretë: Paraqitet pjesa empirike e hulumtimit, e realizuar në administratën publike të Komunës së Podujevës. Analizohen karakteristikat demografike të pjesëmarrësve, perceptimet e tyre lidhur me transparencën, përdorimin e platformave të e-qeverisjes, angazhimin qytetar, motivimin në punë, etikën profesionale dhe cilësinë e shërbimeve publike. Gjithashtu interpretohen rezultatet statistikore të pyetësorëve dhe intervistave.

Në kapitullin e katërt: Trajtohet testimi i hipotezave të studimit përmes analizave statistikore, duke përfshirë analizën e korrelacionit dhe testet statistikore për të vlerësuar ndikimin e mekanizmave institucionale, teknologjisë, pjesëmarrjes qytetare dhe faktorëve të tjerë në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike të Komunës së Podujevës. Rezultatet interpretohen në raport me objektivat dhe pyetjet kërkimore të studimit.

Pjesa përmbyllëse: Përmbledh gjetjet kryesore të hulumtimit dhe nxjerr përfundimet lidhur me rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike. Në këtë pjesë theksohet se zbatimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionale, përdorimi i teknologjisë, përfshirja aktive e qytetarëve dhe respektimi i etikës profesionale ndikojnë pozitivisht në rritjen e transparencës, efikasitetit dhe besimit të publikut ndaj institucioneve lokale. Gjithashtu paraqiten rekomandime konkrete për përmirësimin e praktikave administrative dhe forcimin e qeverisjes së mirë në Komunën e Podujevës. Në fund të punimit paraqitet bibliografia, e përbërë nga literaturë shkencore bashkëkohore, dokumente ligjore, raporte institucionale dhe burime të tjera relevante që kanë shërbyer si bazë për realizimin e këtij studimi.

Pyetjet hulumtuese:

- Cilat janë mekanizmat më efektivë ligjorë dhe institucionale për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien në administratën publike?
- Si ndikon përdorimi i teknologjisë dhe inovacioneve, si e-qeverisja, në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike?
- Cilat janë pengesat kryesore që pengojnë zbatimin e plotë të transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike dhe si mund të adresohen ato?
- Çfarë mësimesh mund të nxirren nga krahasimi i praktikave ndërkombëtare për transparencën dhe llogaridhënien në administratën publike?
- Si mund të përmirësohet përfshirja dhe angazhimi i publikut në proceset administrative për të rritur transparencën dhe llogaridhënien?

Hipotezat e punimit

- **Hipoteza 1:** Implementimi i mekanizmave të fuqishëm ligjorë dhe institucionalë rrit në mënyrë të konsiderueshme nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike.
- **Hipoteza 2:** Përdorimi i teknologjisë dhe inovacioneve, si e-qeverisja, ka një ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënie në administratën publike.
- **Hipoteza 3:** Identifikimi dhe adresimi i pengesave kryesore, si burokracia dhe ndërhyrja politike, janë kritike për zbatimin efektiv të transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike.
- **Hipoteza 4:** Përfshirja aktive e publikut dhe angazhimi qytetar në proceset administrative përmirëson transparencën dhe llogaridhënien në administratën publike.